


PHILIPS

Boks me valë

TAS2505

Manuali i përdoruesit



Regjistroni produktin dhe merrni mbështetje në
www.philips.com/support

Përmbajtja

I	Të rëndësishme	2
	Siguria	2
2	Boksi juaj me valë	3
	Hyrje	3
	Çfarë ka në kuti	3
	Përmbledhje për boksen	3
3	Fillimi	4
	Karikimi i baterisë së brendshme	4
	Ndezja/fikja	4
4	Luajtja nga pajisjet me Bluetooth	5
	Luajtja nga pajisjet me Bluetooth	5
	Kontrolli i luajtjes	5
	Kontrollimi i telefonatës	5
5	Informacione për produktin	6
6	Zgjidhja e problemeve	7
	Të përgjithshme	7
	Bluetooth	7
7	Njoftim	8
	Pajtueshmëria	8
	Kujdesi për mjedisin	8
	Deklarata FCC	8
	Njoftim për markën tregtare	9

I E rëndësishme

Siguria

Udhëzime të rëndësishme sigurie

- Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin mbrapa ose poshtë pajisjes.
- Boksi nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.
- Mos vini asnjë burim rreziku mbi boks (p.sh. objekte të mbushura me lëng, qirinj të ndezur).
- Sigurohuni që të ketë hapësirë të lirë të mjaftueshme anembanë boksit për ajrim.
- Ju lutemi përdoreni boksën në mënyrë të sigurt në ambient me temperaturë ndërmjet 0°C dhe 45°C.
- Përdorni vetëm pjesë dhe aksesore që janë specifikuar nga prodhuesi.

Masat paraprake për baterinë

- Rrezik shpërthimi nëse bateria nuk vendoset si duhet. Zëvendësoni vetëm me të njëjtin tip ose me tip ekuivalent.
- Bateria (paketa e baterive ose bateritë e instaluar) nuk duhet të ekspozohen ndaj nxehtësisë së tepërt, si për shembull ndaj dritës së diellit, zjarrit ose gjërave të ngjashme.
- Në rast se bateria arrin temperatura tepër të larta ose tepër të ulëta gjatë përdorimit, ruajtjes ose transportit, dhe presion atmosferik të ulët në lartësi të lartë, kjo mund të sjellë rreziqe sigurie.
- Mos e ndërroni një bateri me një tip të gabuar, pasi kjo mund të përbëjë rrezik (për shembull, disa lloje baterish litiumi).

- Hedhja e baterisë në zjarr ose në furrë të nxehtë, ose shtypja mekanike apo prerja e baterisë, të cilat mund të shkaktojnë shpërthim.
- Lënia e baterisë në temperaturë ambienti tepër të lartë, ose në mjedis me presion atmosferik tepër të ulët mund të shkaktojë shpërthim ose rrjedhje të lëngjeve ose gazrave të djegshëm.



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e këtij boksi.
- Asnjëherë mos lubrifikoni asnjë pjesë të këtij boksi.
- Vendoseni këtë boks mbi një sipërfaqe të sheshtë, të fortë dhe të qëndrueshme.
- Asnjëherë mos e vendosni këtë boks mbi pajisje të tjera elektronike.
- Përdoreni këtë boks vetëm brenda. Mbajeni këtë boks larg nga uji, lagështia dhe nga objektet e mbushura me lëngje.
- Mbajeni boksën larg nga drita direkte e diellit, flakët e ndezura ose nxehtësia.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria ndërrohet me një tip të gabuar.

2 Boksi juaj portativ


Urime për blerjen tuaj dhe mirësevini te Philips!
Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron Philips, regjistroni produktin në www.philips.com/welcome.

Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe dalloni gjërat që ka në kuti:

- Boksi
- Kablli USB
- Udhëzues i nisjes së shpejtë
- Dokumenti i të dhënave të sigurisë
- Garancia mbarëbotërore
- Rripi

Përmbledhje për boksen



- 1**
 - Ndizeni ose fikeni boksen.
 - Kontrolloni nivelin e baterisë.
 - Shfaq gjendjen e baterisë.
 - Fshi informacionet e çiftimit me Bluetooth.
- 2**
 - Shtypni për të ndezur ose fikur dritën LED shumëngjyrëshe.
- 3**
 - Në modalitetin e Bluetooth, shtypni për të ndaluar ose vazhduar luajtjen.
 - Në modalitetin e Bluetooth, shtypni dy herë për të luajtur këngën tjetër.
 - Përgjigjuni një telefonate hyrëse nëpërmjet lidhjes me Bluetooth.
- 4**
 - Rregulloni volumn.
- 5** **DC IN**
 - Karikimi i baterisë së brendshme.

3 Fillimi

Ndiqui gjithnjë me radhë udhëzimet në këtë kapitull.


Karikimi i baterisë së brendshme

Boksi vihet në punë nga një bateri e brendshme e karikueshme.

Shënim

- Para se ta përdorni, karikojeni plotësisht baterinë e brendshme.
- Priza USB-C është vetëm për karikim.
- Duhet rreth dy orë e gjysmë që bateria e brendshme të karikohet plotësisht.
- Bateria e karikueshme ka një numër të kufizuar ciklesh karikimi. Jetëgjatësia e baterisë dhe numri i cikleve të karikimit ndryshon sipas përdorimit dhe cilësimeve.

Lidhni prizën USB-C të boksit me një prizë (5V, = 1A) duke përdorur kabllo USB të dhënë.



Ndezja

- ↳ Kur boksi duke u karikuar, drita LED është e kuqe solide.
- ↳ Kur boksi është karikuar plotësisht, drita LED është blu solide.

Fikja

- ↳ Kur boksi duke u karikuar, drita LED është e kuqe solide.
- ↳ Kur boksi është karikuar plotësisht, drita LED fiket.




Kujdes

- Rrezik i dëmtimit të boksit! Sigurohuni që tensioni i furnizimit me energji përputhet me tensionin që tregohet mbrapa ose poshtë boksit.
- Rrezik goditjeje elektrike! Kur e shkëputni kabllo USB, tërhiqeni gjithnjë nga spina. Asnjëherë mos tërhiqni kabllo.
- Përdorni vetëm kabllo USB të specifikuar nga prodhuesi ose që shitet bashkë me këtë boks.

Ndezja/fikja

- Për ta ndezur boks, mbani shtypur "⏻" për dy sekonda. Do të dëgjoni tingullin lajmërues dhe drita LED treguese ngjyrë blu pulson.



- Për ta fikur boks, mbani shtypur "⏻" për dy sekonda. Do të dëgjoni tingullin lajmërues dhe drita LED fiket.
- Nëse nuk ka asnjë lidhje Bluetooth, ai fiket automatikisht.

4 Luajtja nga pajisjet me Bluetooth

Me këtë boks mund të dëgjoni audio nga pajisjet me Bluetooth.




Shënim

- Boksi mund të ruajë në memorie deri në tetë pajisje të çiftuara. Pajisja e nëntë do të zëvendësojë të parën.
- Çdo pengesë mes këtij boksi dhe një pajisjeje me Bluetooth mund ta pakësojë rrezën funksionale.
- Mbajeni larg nga çdo pajisje elektronike që mund të shkaktojë interferenca.
- Rrezja funksionale mes këtij boksi dhe një pajisjeje me Bluetooth është rreth 20 metra.

Lidhja e një pajisjeje

- 1 Shtypni  për dy sekonda për ta ndezur boksën.
 - » Drita treguese LED pulson ngjyrë blu.



- 2 Në pajisjen tuaj me Bluetooth, aktivizoni Bluetooth dhe kërkonte pajisjet që mund të çiftohen.
- 3 Zgjidhni [Philips S2505] që shfaqet në pajisjen tuaj për të bërë çiftimin dhe lidhjen. Nëse është e nevojshme, shkruani "0000" si fjalëkalim për çiftimin.

- » Pasi çiftimi dhe lidhja të jetë bërë me sukses do të dëgjoni tingullin lajmërues dhe drita treguese LED bëhet ngjyrë blu solide.
- » Nëse nuk e gjeni dot [Philips S2505] në pajisjen tuaj, mbani shtypur  për më shumë se tre sekonda derisa të dëgjoni tingullin lajmërues.

- 4 Luani audio në pajisjen tuaj me Bluetooth për të filluar kalimin e muzikës.



Këshillë

- Mund ta përdorni pajisjen me Bluetooth për të kontrolluar luajtjen.

Treguesi LED (blu)

Treguesi	Statusi i lidhjes së Bluetooth
Pulsim i shpejtë (2Hz)	Duke u çiftuar
Pulson ngadalë (1Hz)	Duke u lidhur
Blu solide	Është lidhur

Shkëputja e një pajisjeje

- Shtypni për pak  për ta shkëputur nga çiftimi aktual;
- Për t'i fshirë informacionet e çiftimit, mbani shtypur  për më shumë se 5 sekonda derisa të dëgjoni tingullin lajmërues.
- Çaktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj; ose
- Largojeni pajisjen përtej rrezes së komunikimit.
 - » Do të dëgjoni tingullin lajmërues dhe treguesi LED pulson ngjyrë blu.



Shënim

- Para se të lidhni një pajisje tjetër me Bluetooth, shkëputeni pajisjen aktuale më parë.

Lidhni përsëri një pajisje.

Kur e ndizni boksën, ai do të lidhet përsëri me pajisjen e lidhur për herë të fundit; nëse jo, zgjidhni [Philips S2505] në pajisjen tuaj me Bluetooth për të filluar lidhjen.

5 Informacione për produktin

Shënim

- Informacionet për produktin mund të ndryshohen pa u njoftuar paraprakisht.

Amplifikatori

Fuqia nominale output	3W RMS
Përgjigja e frekuencës	120Hz - 18kHz
Raporti sinjal-zhurmë	> 70 dBA

Boksi

Impedanca e boksit	4 ohm
Drajveri i boksit	1.75" rreze e plotë
Ndjeshmëria	> 80dB/m/W

Bluetooth

Versioni i Bluetooth	V5.0
Profil i Bluetooth	A2DP V1.3, HFP V1.7 AVRCP V1.6
Banda e frekuencës së Bluetooth	2402-2480 MHz
Rrezja e Bluetooth	20 m (hapësirë e lirë)

Informacion i përgjithshëm

Energjia (nëpërmjet prizës micro USB)	5V, 1 A
Bateri e brendshme me polimere litiumi	3.7 V, 850mAh
Përmasat - Njësia kryesore (Gje × La × Tra)	91.5 × 91 × 41mm
Pesha - Njësia kryesore	0,19 kg
Temperatura e ambientit	0°C~40°C
Kategoria e mbrojtjes IP	IP × 7

6 Zgjidhja e problemeve



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e kësaj pajisjeje.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni sistemin vetë.

Nëse hasni probleme ndërsa përdorni pajisjen, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkonti shërbime. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips (www.philips.com/support). Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që pajisja është pranë dhe të keni gati numrin e modelit dhe numrin e serisë.

Nuk është e mundur lidhja e pajisjes.

- Funkcioni Bluetooth i pajisjes nuk është aktivizuar. Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes se si ta aktivizoni funksionin.
- Ky produkt është lidhur tashmë me një pajisje tjetër me Bluetooth. Shkëputeni pajisjen dhe provoni përsëri.

Pajisja e çiftuar lidhet dhe shkëputet automatikisht.

- Sinjali i Bluetooth është i dobët. Afrojeni më shumë pajisjen me produktin ose hiqni çdo pengesë mes tyre.
- Për disa pajisje, lidhja e Bluetooth mund të çaktivizohet automatikisht si veçori për kursimin e energjisë. Kjo nuk do të thotë se në produkt ka ndonjë defekt.

Të përgjithshme

Nuk ndizet

- Karikojeni baksin.

Nuk ka zë

- Sigurohuni që pajisja me Bluetooth të jetë brenda distancës funksionale.

Nuk ka përgjigje nga boksi

- Karikojeni baksin.

Informacion rreth pajisjes me Bluetooth

Cilësia e audios është e dobët pas lidhjes me një pajisje me Bluetooth.

- Sinjali i Bluetooth është i dobët: Afrojeni më shumë pajisjen me produktin, ose hiqni çdo pengesë mes tyre.

Nuk gjeni dot [Philips S2505] në pajisjen tuaj për të bërë çiftimin.

- Nëse nuk e gjeni dot [Philips S2505] në pajisjen tuaj, mbani shtypur butonin  për ta fikur para se ta rindizni, ose shtypeni për pak për të hyrë në modalitetin e çiftimit.

7 Njoftim

Çdo ndryshim ose modifikim që bëhet në këtë pajisje dhe që nuk është miratuar shprehimisht nga **MMD Hong Kong Holding Limited** mund ta bëjë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.

Pajtueshmëria



Këtu, **TP Vision Europe B.V.** deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 1999/5/EC. Deklaratën e konformitetit mund ta gjeni në www.philips.com/support.

Kujdesi për mjedisin

Hedhja e produktit dhe baterisë së vjetër



Produkti juaj është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësishë së lartë, të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol mbi produktin do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/BE.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban një bateri të integruar të karikueshme të mbuluar nga Direktiva Evropiane 2013/56/BE, e cila nuk mund të asgjësohet me mbetje normale shtëpiake. Ju këshillojmë fort që ta çoni produktin


në një pikë zyrtare grumbullimi ose të një qendër servisi Philips që bateria e karikueshme të hiqet nga një profesionist. Informohuni për sistemin lokal të ndarë për produkte elektrike ose elektronike dhe bateri të karikueshme. Ndiqui rregullat lokale dhe mos e asgjësoni asnjëherë produktin dhe bateritë e karikueshme me mbetjet normale shtëpiake. Hedhja e duhur i produkteve të vjetra dhe baterive të karikueshme ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.



Kujdes

- Heqja e baterisë së brendshme e bën garancinë të pavlefshme dhe mund ta dëmtojë produktin.

Çojeni gjithnjë produktin te një profesionist për ta hequr baterinë.



Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin të lehtë për t'u ndarë në tre materiale: karton (kutia), shumë polisteroli (amortizatori) dhe polietilen (qeset, fleta e shumës mbrojtëse.) Sistemi përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi ndiqni rregullat vendëse lidhur me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.

Hedhja e baterisë në zjarr ose në furrë të nxehtë, ose shtypja mekanike apo prerja e baterisë, të cilat mund të shkaktojnë shpërthim

Deklarata FCC

Kjo pajisje i përmbahet pjesës 15 të rregullave FCC. Përdorimi është objekt i dy kushteve të mëposhtme: (1) Kjo pajisje nuk mund të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe (2) Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë operim të padëshiruar.

Paralajmërim: Ndryshimet ose modifikimet që nuk janë miratuar shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund ta bëjnë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.

Shënim: Kjo pajisje është testuar dhe është zbuluar se i përmbahet limiteve për një pajisje dixhitale të Klasit B, sipas pikës 15 të rregullave FCC.

Këto kufij janë projektuar për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencës së dëmshme në një instalim rezidencial. Pajisja gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencave radio dhe, nëse nuk instalohet dhe nuk përdoret sipas udhëzimeve, mund të shkaktojë interferencë të dëmshme ndaj komunikimeve radio. Sidoqoftë, nuk ka garanci që interferenca nuk do të ndodhë në një instalim të veçantë. Nëse kjo pajisje shkakton interferencë të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë e cila mund të përcaktohet duke e ndezur dhe fikur pajisjen, përdoruesi inkurajohet që të përpiqet ta ndreqë interferencën nëpërmjet një ose më shumë prej masave të mëposhtme: (1) Ndryshoni orientimin ose lëvizeni antenën. (2) Largoni distancën mes pajisjes dhe marrësit. (3) Lidhni pajisjen në një prizë që ndodhet në një qark të ndryshëm nga ai në të cilin është lidhur marrësi. (4) Konsultohuni me shitësin ose me një teknik radio/TV me eksperiencë për ndihmë.

Deklarata e paralajmërimit për RF

Pajisja është vlerësuar se i përmbush kërkesat e përgjithshme të ekspozimit RF. Kjo pajisje mund të përdoret në kushte portative ekspozimi pa kufizime.

Njoftim për markën tregtare



Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka të regjistruara tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga **MMD Hong Kong Holding Limited** bëhet me licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtar janë të pronarëve të tyre përkatës.



Specifikimet janë objekt ndryshimi pa njoftim.

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka të tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë.

Ky produkt është prodhuar dhe shitet me përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited ose një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

TAS2505_00_UM_VI.0

